

GJYKATA E APELIT

Lënda numër: PAKR 77/2017

Data: 14 Nëntor 2017

Gjykata e Apelit të Kosovës me Panelin e përbërë prej Gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Driton Muharremi si Kryesues i Panelit, Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant si Gjyqtare Raportuese, dhe Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Abdullah Ahmeti si anëtar i Panelit, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Kerry Moyes si Procesmbajtëse, në procedurën penale kundër:

M.S.;

I akuzuar me Aktakuzën PPS No 5/2012 të ngritur më 27 dhjetor 2013, si vijon:

Akuza 1 – Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 339 (1) dhe (2) në ndërlidhje me nenin 23 të ish-Kodit Penal të Kosovës (CCK), aktualisht e dënueshme me nenin 422 në ndërlidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013;

Akuza 2 – Marrje të Ryshfetit, në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 343 (1) në ndërlidhje me nenin 23 të ish-KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 428 në ndërlidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013;

Akuza 3 – Ushtrimi i Ndikimit, në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 345 (1) në ndërlidhje me nenin 23 të ish-KPK-së, aktualisht e dënueshme me nenin 431 (1) dhe nenin 31 të KPK-së të vitit 2013;

Akuza 4 – Shmangie nga Pagesa e Tarifave të Detyrueshme Doganore, në bashkëkryerje, në shkelje të nenit 318 (1) dhe (4) në ndërlidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013;

Akuza 5 – Dhënie të Ndhmës Kryesve pas Kryerjes së Veprave Penale, në shkelje të nenit 388 (1) të KPK-së të vitit 2013;

Akuza 6 – Dhënie të Ndhmës Kryesve pas Kryerjes së Veprave Penale, në shkelje të nenit 388 (1) dhe (2) të KPK-së të vitit 2013;

Akuza 7 – Moslajmërim i Veprave Penale apo Kryesve të Tyre, në shkelje të nenit 386 (1) nën-paragrafit 9 të KPK-së të vitit 2013;

Akuza 8 – Mbajtje në Pronësi, Kontroll ose Posedim të Paautorizuar të Armëve, në shkelje të nenit 374 (1), në ndërlidhje me nenin 120, pika 38 e KPK-së të vitit 2013;

Duke vendosur sipas kërkesës së avokatit mbrojtës të M.S., të parashtruar gojarisht gjatë seancës publike të Panelit të Apelit më 29 shtator 2017;

Pas dëgjimit të përgjigjes së Prokurorit të Apelit, të paraqitur gjatë të njëjtës seancë;

Pas diskutimit më 11 tetor 2017 dhe diskutimit të mëtejshëm dhe votimit më 14 nëntor 2017;

Sipas nenit 402, paragrafit 4 dhe nenit 178 të Kodit të Procedurës Penale (KPP);

Nxjerrë këtë:

AKTVENDIM

- 1. I pandehuri M.S. lirohet menjëherë nga masa e paraburgimit.**
 - 2. I pandehuri M.S. urdhërohet të lajmërohet në stacionin policor të Ferizajt njëherë në javë, në çdo të hënë.**
 - 3. Dokumentet e udhëtimit të pandehurit M.S. janë konfiskuar përkohësisht, dhe i pandehuri duhet ti dorëzoj dokumentet e tija të udhëtimit në Zyrën e Prokurorit të Shtetit brenda 48 orëve nga momenti i lirimt nga paraburgimi.**
 - 4. Gjykata mund të urdhëroj që të shqiptohet masa e paraburgimit nëse i pandehuri e shkel këtë Aktvendim.**
-

ARSYETIMI

HISTORIKU RELEVANT PROCEDURAL

1. Më 23 mars 2013, Prokurori lëshoi një Vendim për Fillimin e Hetimit, i cili është zgjeruar më 28 mars 2013 pas lëshimit nga Prokurori të një Vendimi për ta Zgjeruar Hetimin.
2. Më 11 shtator 2013 i pandehuri M.S. është arrestuar dhe më 12 shtator 2013 Gjykatësi i procedurës paraprake ka urdhëruar masën e paraburgimit kundër të gjithë të pandehurve në rast, përfshirë të pandehurin M.S. Ai është liruar në arrest shtëpiak më 28 prill 2015. Ai qëndroi në arrest shtëpiak derisa kjo masë është tërhequr më 6 tetor 2016, dhe masa e paraburgimit i është shqiptuar për shkak se me aktgjykimin e shpallur në të njëjtën ditë, ai është dënuar me 8 vjet burg.
3. Aktgjykimi është ankimuar nga të dy palët, Avokati mbrojtës i të pandehurit M.S. dhe nga Prokurori.
4. Paneli i Apelit diskutoi më 11 tetor dhe më 14 nëntor 2017. Në këtë ditën e dytë, Paneli votoi.

KONSTATIMET E GJYKATËS SË APELIT

5. Gjykata e Apelit vendosi ta aprovoj ankesën e parashtruar nga i pandehuri M.S. dhe Avokati i tij mbrojtës A.R., më 26 janar 2017, ta refuzoj ankesën e parashtruar nga Prokurori Special më 26 janar 2017, ta anuloj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Ferizajt P. nr. 250/2013 të datës 6 tetor, dhe ta kthej lëndën në rigjykim. Duke qenë kështu, Gjykata e Apelit e shqyrtoi çështjen e paraburgimit të vazhdueshëm të pandehurit M.S., sipas paragrafit 4 të nenit 402 të KPP-së.
6. Gjykata e Apelit vëren se i pandehuri M.S. ka qenë në paraburgim që prej 12 shtatorit 2013. Kjo është më shumë se 4 vjet. Gjykimi i parë zgjati për një periudhë të gjatë kohore, gati 2 vjet e gjysmë. Pasi që vendimi i Gjykatës së Apelit është që ta kthej lëndën në rigjykim, me gjasë do të duhet një periudhë e konsiderueshme kohore që të përfundoj rigjykimi. Për këtë, Gjykata e Apelit e shqyrtoi nëse kushtet e neneve 185 dhe 187 të KPP-së vazhdojnë të jenë të plotësuara, dhe konstatoi se nuk janë. Në vend të kësaj, Gjykata e Apelit konsideron se masa e lajmërimit në stacion policor, sipas nenit 178 të KPP-së, është e mjaftueshme për ti evituar rreziqet sa i përket të pandehurit M.S.

7. Pasi që lënda është kthyer në Gjykatë Themelore për rigjykim, dyshimi i bazuar se i pandehuri M.S. ka kryer veprën penale, vazhdon të ekzistoj. Veprat penale me të cilat ai është akuzuar, janë të rënda, dhe ndëshkimi i mundshëm nëse dënohet, paraqet një motiv të fortë për të pandehurin që të arratiset apo të fshihet. I pandehuri është person me mundësi të konsiderueshme financiare, dhe të cilat janë të mjaftueshme për ta financuar një veprim të tillë. Për këtë, kushtet për masën e lajmërimit në Stacion Policor, në përputhje me nenin 178, paragrafin 1 të KPP-së janë plotësuar. Më tutje Paneli shqipton konfiskimin e përkohshëm të dokumenteve të udhëtimit të pandehurit, në përputhje me nenin 178, paragrafin 7 të KPP-së. Gjykata e Apelit konstaton se kjo masë është e mjaftueshme për ti evituar rreziqet dhe se një masë më e rëndë kufizuese nuk është e arsyeshme më.
8. Për këtë, është vendosur si në dispozitiv.

Shkruar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Aktvendimi i arsyetuar është përfunduar më 14 nëntor 2017.

Kryetari i Kolegjit

Procesmbajtëse

Driton Muharremi

Kerry Moyes

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Zyrtare Ligjore e EULEX-it